




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. l. fq. 02
 Nr. pages 02

Nr. Prot. 01-649/15
 Br. Prot. 01-649/15
 Prot. No. 01-649/15
 Data 04-03-2015
 Datum 04-03-2015

PRISTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.03.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-105/15, për z. Bahri Bokshi, Anëtar i Kuvendit Komunal të Gjakovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Bahri Bokshi, Anëtar i Kuvendit Komunal të Gjakovës, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimi të kësaj shkrese, kemi informuar zyrtarin e lartë për gjendjen në të cilin ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Bokshi, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të hequr dorë nga funksioni menagjues në biznesin privat në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, zyrtari i lartë z. Bokshi ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/485/15) në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat Sh.P.K “Alfa Teks”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

